



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

# DITARI MUJOR SHTATOR 2024

## 300 shkolla me laboratorë inteligjentë

Edhe 200 shkolla të tjera në të gjithë vendin janë pajisur me 216 laboratorë SMART këtë vit, duke zgjeruar programin e kodimit, i cili tashmë përfshin 35 mijë fëmijë të arsimit fillor në kurrikulën e re të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Deri më tani, numri i shkollave të pajisura me SmartLabs ka shkuar në 300. Harta digjitale në shkolla do të zgjerohet me 654 SMARTLab-e dy vitet e ardhshme. Synimi është që të gjitha shkollat të jenë të pajisura me laboratorë, duke nxitur të mësuarit përmes platformave interaktive dhe rritur aftësitë digjitale të nxënësve.



### Rritet numri i oficerëve të sigurisë në shkolla

Viti i ri shkollor 2024-2025 nisi me një numër të shtuar të oficerëve të sigurisë, 40 më shumë se një vit më parë, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 240. Me rastin e fillimit të shkollës, kryeministri Edi Rama, ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu dhe ministri i Brendshëm Ervin Hoxha zhvilluan një takim me oficerët e sigurisë, duke theksuar edhe një herë rëndësinë që ata kanë në garantimin e ambienteve të sigurta për nxënësit e arsimit parashkollor dhe trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës.

### Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve, nis faza e dytë e trajnimit

Nisi faza e dytë e Programit Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve, i cili do të shtrihet edhe përgjatë vitit 2025 për mësuesit e arsimit fillor, në gjuhë shqipe, matematikë, fizikë, kimi. Ky proces po zhvillohet për herë të parë në bashkëpunim me shtatë Institucionet e Arsimit të Lartë, të cilat vënë në dispozicion stafin e tyre pedagogjik për të informuar mësuesit jo vetëm me metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar ka nisur trajnimi nga 5 IAL: Elbasan, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.



### "Jordan Misja" dhe Shkolla Koreografike marrin "Statusin e veçantë"

Dy shkolla historike me orientim artistik, Liceu Artistik "Jordan Misja" dhe Shkolla Koreografike e Tiranës morën "Statusin e veçantë" Marrja e këtij statusi do të sjellë një zhvillim të ri për edukimin artistik dhe mbështetjen e talenteve të reja. Tanimë këto dy institucione do të kenë një trajtim të veçantë financiar, më shumë autonomi financiare, duke krijuar hapësira për krijimin e fondeve jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga burime të tjera.

## Viti i ri shkollor, 25 shkolla të reja hapin dyert për 10 mijë nxënës



Me përirimin e 25 shkollave të reja, që ofrojnë kushte bashkëkohore për 10 mijë nxënës dhe mësues, nisi viti i ri shkollor 2024-2025. Në këtë 9 shtator u ulën në bankat e shkollave 350 mijë nxënës të arsimit parauniversitar, prej të cilëve 28 mijë u përkisnin klasave të para. Së bashku me kryeministrin e vendit, z. Edi Rama, urimin për fillimin e një viti të mbarë ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu e dha nga shkolla e mesme e përgjithshme "Babë Dudë Karbunara" në Berat. Një shkollë-model, e cila u rihap për nxënësit dhe mësuesit e saj pas procesit të rikonstruksionit, si një investim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë së Beratit. Ministria Manastirliu u shpreh se ky vit shkollor nisi me një staf mësuesish më të motivuar falë rritjes së pagës mesatare deri në 950 euro, me kushte më të mira për arsimin parauniversitar, por edhe një ambient më miqësor dhe të sigurt falë shtimit të numrit të punonjësve psiko-socialë dhe të oficerëve të sigurisë.

### LEHTËSOHET KALIMI NË ARSIMIN PROFESIONAL, NËSHKRUHET UDHËZIMI MES MAS DHE MEKI

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nënshkruan dokumentin e përbashkët që u hap rrugë të rinjve për të zgjedhur arsimin profesional gjatë gjithë vitit të parë të gjimnazit. Procesi i regjistrimit të nxënësve në arsimin profesional u shtri përgjatë gjithë muajit shtator dhe mbi 15 mijë nxënës ndjekin aktualisht arsimin profesional, prej të cilëve mbi 4,400 nxënës janë regjistruar këtë vit, ose 10% më shumë se një vit më parë. MAS luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e procedurave të kalimit nga njëri sistem në tjetrin dhe rishikimin e kurrikulës së përgjithshme.



### DY ROLET E REJA NË SHKOLLË, SHPALLET THIRRJA PËR 640 KOORDINATORË

Nisi procesi i përzgjedhjes së dy roleve të reja në shkollë, që do të sjellin një ndryshim të rëndësishëm në rritjen e cilësisë në arsim dhe orientimin të nxënësve për shkollimin e mëtejshëm: Mësuesi Koordinator i Karrierës dhe Mësuesi Koordinator i Sigurimit të Cilësisë. Do të jenë 320 koordinatorë të cilësisë, që do të shërbejnë si një mekanizëm i brendshëm për rritjen e performancës së mësuesve në shkollë dhe 320 këshillues karriere, që mbi bazën e arritjeve dhe aftësive do të orientojnë nxënësit drejt arsimit të përgjithshëm apo profesional. Pas shpalljes së thirrjes në 20 shtator, pritet shpallja e fituesve.